

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Krimeve të Rënda, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarët Afrim Shala, kryetar i trupit gjykues, Mirevete Alidemi dhe Veli Kryeziu, anëtarë të trupit gjykues, me sekretaren juridike Vahide Dërmaku, në çështjen penale ndaj të akuzuarit R. M., nga Gj., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 153 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nënparagrafi 4 i Kodit Penal të Kosovës,<sup>1</sup> të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokati Xh. Xh., nga Gj. dhe ndaj të akuzuarit A. Xh. nga Gj., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 189 paragrafi 1 nënparagrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës,<sup>2</sup> të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokati M. A., nga Gj., sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut në Gjilan,<sup>3</sup> PP.nr.53/2012, e datës 22.03.2012, të cilën e përfaqësonte prokurori Shaban Spahiu, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, të datës 09.06.2015, në të njëjtën datë mori dhe shpalli këtë :

## AKTGJYKIM

## I.

I akuzuari R. M., nga babai F. dhe nëna T., e lindur D., i lindur më ..., në Gj., ku edhe J., rruga "...", nr. ... , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i një fëmiju, gjatë kohës sa ka qenë në liri ka punuar në ... e tij, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, ka qenë i dënuar edhe më parë vepra tjera penale,

## ËSHTË FAJTOR

Me datën ... .2012, diku rreth orës ... minuta, në kafiterinë "...", në rrugën "...", në Gj., pas një grindje dhe mosmarrëveshje që kishte patur me të dëmtuarin J. Q., nga fshati M., Komuna e Gj., të njëjtit i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore, në atë mënyrë që fillimisht e godet me një shishe qelqi të birrës në fytyrë, e më

<sup>1</sup> Kodi i Penal i Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPK) - Rregullorja e UNMIK-ut, nr.25/2003, e datës 06.07.2003.

<sup>2</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

<sup>3</sup> Prokuroria Publike e Qarkut në Gjilan, në tekstin e mëtejme PPQ në Gjilan

pastaj kur i dëmtuari J., del jashtë kafiterisë dhe kishte hyrë në një veturë taksit për të shkuar për ndihmë mjekësore, i akuzuari R. M. e nxjerr thikën nga xhepi, duke u vërsulur në drejtim të tij, me ç'rast kishte kapur dorëzën e derës së automjetit për ta qelur derën dhe tenton edhe ta godas me thikë, por në ato çaste nga mbrapa e ka tërhequr i akuzuari A. Xh. ndërsa, i dëmtuari J., si rast urgjent dërgohet në Qendrën Spitalore në Gjilan,

- me këtë ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor, nga neni 153 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nënparagrafi 4 të KPK.

Andaj, trupi gjykues në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 3, 34, 35, 36, 38 dhe 64 të KPK, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale,<sup>4</sup> të akuzuarit i shqipton :

## DËNIM ME BURGIM

Ashtu që të akuzuarit R. M., i caktohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muajve, të cilin dënim i akuzuari do ta mbajë pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Të akuzuarit R. M., në dënimin e shqiptuar me burgim, do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 27.02.2012 e deri më datën 23.03.2013, ashtu që 1 (një) ditë e qëndrimit në paraburgim do të barazohet me 1 (një) ditë të dënimit me burgim.

Detyrohet i akuzuari R. M., që ta paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 50 €, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

## II.

Ndaj të akuzuarit A. XH. nga babai Sh. dhe nëna Xh., e lindur M., i lindur më datën ..., në P., tani me vendbanim në Gj., rruga "...", shqiptar, qytetar i Republikës së Kosovës, i pamartuar, teknik ..., i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, duke u bazuar në nenin 363 paragrafi 1 nënparagrafi 1 të KPP,

## REFUZOHET AKUZA

---

<sup>4</sup> Kodi i Procedurës Penale (Në tekstin e mëtejshëm KPP), nr.04/L-123, i datës 13.12.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

Sepse në kohën dhe vendin si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi, pas një grindje me fjalë me të dëmtuarin J. Q., të njëjtin e godet me grusht dore, duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, ashtu që i dëmtuari detyrohet të kërkojë ndihmë mjekësore,

- me këtë kishte për të kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor, nga 189 paragrafi 1 nënparagrafi 1 të KPRK.

Shpenzimet e procedurës penale sa i përket të akuzuarit A. Xh. paguhen nga mjetet buxhetore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

## ARSYETIMI

### 1. Ecuria e procedurës dhe fjala përfundimtare e palëve

PPQ në Gjilan, më datën 22.03.2012, ka ngritur aktakuzën PP.nr.53/2012 ndaj të akuzuarit R. M., nga Gjilani, për shkak të veprës penale vrasje e mbetur në tentativë, nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK dhe ndaj të akuzuarit A. Xh. nga Gjilani, për shkak të veprës penale pjesëmarrja në rrahje, nga neni 155 paragrafi 1 i KPK.

Pas kësaj, kryetari i trupit gjykues e ka caktuar shqyrtimin gjyqësor, i cili është mbajtur më datën 09.06.2015, ku prokurori i shtetit Shaban Spahiu, e ka bërë përmirësimin e aktakuzës, ndërsa sa i përket të akuzuarit A. Xh. e ka bërë edhe rikualifikimin ligjor të veprës penale, ç'rast të njëjtin e ka akuzuar për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor, nga neni 189 paragrafi 1 nënparagrafi 1 i KPRK.

Ndërsa, gjatë fjalës përfundimtare, prokurori i shtetit Shaban Spahiu, ka mbetur në tërësi pranë kësaj aktakuze, të plotësuar dhe ndryshuar, sa i përket të akuzuarit R. M., duke i propozuar trupit gjykues që këtë të akuzuar ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet dhe ta dënojë sipas ligjit. Ndërsa, në mungesë të provave, prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza ndaj të akuzuarit A. Xh. .

Mbrojtësi i të akuzuarit R. M., avokati Xh. Xh., gjatë fjalës përfundimtare ka deklaruar se nuk ka prova me të cilin do të argumentojë se i mbrojturi i tij, ka tentuar që ta privojë nga jeta të dëmtuarin dhe se veprimet e të akuzuarit R. M., i përmbajnë elementet e veprës penale të lëndimit të lehtë trupor, për çka e ka pranuar edhe vetë i akuzuari.

I akuzuari R. M., e ka përkrahur fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, duke shtuar se më vjen keq për rastin që ka ndodhur.

## 2. Provat e administruara gjatë seancës të shqyrtimit gjyqësor

Meqë të akuzuarit R. M. dhe A. Xh. nuk e kanë pranuar fajësinë për kryerjen e veprave penale për të cilat akuzohen, trupi gjykues gjatë shqyrtimit gjyqësor i ka administruar këto prova :

- dëgjimin e të dëmtuarit në cilësi dëshmitarit J. Q.;
- leximin e deklaratave të dëshmitarëve J. Sh.; G. M. dhe B. N.;<sup>5</sup>
- provat materiale, siç janë : fotografitë që gjenden në shkresa të lëndës; raporti i Emergjencës, si dhe mendimi dhe konstatimi i ekspertit mjeko-ligjor dhe
- marrjen në pyetje të akuzuarve R. M. dhe A. Xh..

### 2.1. Deklarata e të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit

I dëmtuari J. Q., gjatë marrjes në pyetje në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar ditën kritike së bashku me dy shokët e tij, kanë shkuar tek kafiteria “...” në Gj., ku aty kanë takuar të akuzuarin A. Xh. i cili ishte së bashku me të akuzuarin R. M.. Fillimit në mes tij dhe të akuzuarit A., kishte filluar një fjalosje për shkak të një mosmarrëveshje të mëparshme, mandej ka ndërhyrë i akuzuari R. M., i cili e ka goditur të dëmtuarin afër buzës, ku ka pasur një gjakosje.

I dëmtuari J. Q., fillimisht ka deklaruar se nuk është i sigurt se me çka e ka goditur i akuzuari R. M., mirëpo gjatë marrjes në pyetje në PPQ në Gjilan,<sup>6</sup> i njëjti kishte deklaruar se “i akuzuari R. M., e kishte goditur me shishe në buzë”.

Po ashtu, dëshmitari J. Q., gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se nuk është i sigurt nëse i akuzuari R. M. gjatë kohës sa kanë qenë në kafiteri të ketë patur ndonjë send me veti, edhe pse gjatë marrjes në pyetje në PPQ në Gjilan, kishte deklaruar se “më është dukur se i akuzuari R. ka patur edhe mjet tjetër, e kujtojë se ka qenë thikë...”.

Gjithashtu, i dëmtuari ka shtuar se pasi ka dal nga kafiteria ka hypur në një taksi dhe të njëjtin e kanë dërguar në Emergjencë. Nuk i është kujtuar nëse e ka parë të akuzuarin R. pasi që ka hyrë në taksi dhe nuk është i sigurt nëse i akuzuari R. ka tentuar që ta hapi derën e veturës së taksist.

---

<sup>5</sup> Trupi gjykues pas dëgjimit të palëve dhe duke u bazuar në nenin 338 paragrafi 1 nënparagrafi 3 të KPP, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka marrë aktvendim me të cilin ka vendosur që të lexohen deklaratat e mëparshme të dëshmitarëve Jeton Shkodra; Gazmend Murati dhe Bekim Nuhiu, të cilët nuk kanë prezantuar në shqyrtim gjyqësor, ngase prokurori i shtetit, të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre, janë pajtuar për një gjë të tillë,

<sup>6</sup> ProcesverbA. mbi dëgjimin e të dëmtuarit – dëshmitarit, i përpiluar më datën 12.03.2012, në Prokurorinë Publike të Qarkut në Gjilan. Gjatë marrjes në pyetje të dëmtuarit Jeton Qamili, më datën 12.03.2012, përveç prokurorit Shaban Spahiu dhe sekretares juridike Hanife Ganiu, ka marrë pjesë edhe mbrojtësi i të akuzuarit Ruzhdi Maliqi, avokati Xhymshiti Xhymshiti.

Dhe në fund, ka deklaruar se para se të ndodhte ky rast, të akuzuarin R. M. nuk e ka njohur dhe arsyeja pse i njëjti e ka goditur ditën kritike të dëmtuarit, është që t'i dal në ndihmë të akuzuarit A. Xh.. Ditën kritike i dëmtuari nuk e ka goditur të akuzuarin R. M. dhe as që e ka shtyrë të njëjtin. Pas ndodhjes së këtij rasti i dëmtuari J. Q. pajtuar me të akuzuarit R. M. dhe A. Xh..

## 2.2. Deklaratat e dëshmitarëve

2.2.1. Dëshmitari J. Sh., gjatë marrjes në pyetje nga ana e prokurorit të PPQ në Gjilan me datën ... 2012<sup>7</sup> ka deklaruar se ditën kritike së bashku me shokët e tij J. Q.n dhe G. M. kanë shkuar te kafiteria "...” në Gj.. Kur kanë hyrë brenda në këtë kafiteri kanë vërejtur se në tavolinë ishte i akuzuari A. me një person tjetër të cilin nuk e kishin njohur më parë, ku me këtë rast J.i është ulur me ta në tavolinë, ndërsa dëshmitari dhe shoku i tij G. kanë kërkuar një tavolinë për tu ulur, mirëpo menjëherë ka filluar konflikti. Konflikti ka filluar menjëherë pasi që J.i ishte ulur në tavolinë me ta, ku për një moment ka vërejtur se personi që ishte me A. dhe J.i janë ngritur në këmbë e pas tyre është ngritur në këmbë edhe A., edhe janë shtyer pak me duar në mes veti. Dëshmitari është munduar që t'i ndajë, por pastaj ka vërejtur se personi që ishte me A.n, përkatësisht i akuzuari R.e ka goditur me gotë të dëmtuarin J., ku pastaj dëshmitari dhe shoku i tij G. kanë hyrë mes tyre dhe kanë arritur që të dalin jashtë kafiterisë. I dëmtuari J., kishte kishte gjakderdhje në buzë dhe të njëjtin e kanë futur në një veturë taksit dhe në ato qaste ka ardhur i akuzuari R. i cili është ofruar te vetura me thikë në dorë dhe ka dashur që ta hap derën e veturës me qëllim që ta sulmojë J.in, mirëpo i njëjti nuk ka arritur që ta hap derën e veturës, ngase e njëjta ishte e mbyllur me bravë nga brenda, ku pastaj e kanë tërhequr të akuzuarin R. ndërsa të dëmtuarin e kanë dërguar në Emergjencë. Dëshmitari ka shtuar se ka vërejtur se i akuzuari R.e kishte këputur edhe dorëzen e veturës, si dhe gjatë kohës kur kanë tentuar ta largojnë R. nuk kanë vërejtur nëse J.i ka gjuajtur me shishe.

2.2.2. Dëshmitari G. M., gjatë marrjes në pyetje në PPQ në Gjilan, me datën ... 2012,<sup>8</sup> ka deklaruar se ditën kritike së bashku me dy shokët e tij J. Q. dhe J. Sh. kanë shkuar te kafiteria "...” dhe kur kanë hyrë në kafiteri e kanë vërejtur të akuzuarin A. Xh. i cili ka qenë me një person tjetër që nuk e ka njohur. Fillimisht janë përshëndetur me këta dy persona, ku i dëmtuari J.i Q., është ulur me ta dhe meqë nuk kishte vend të njëjtit nuk janë ulur me ta dhe derisa po e kërkonin një vend për tu ulur kanë dëgjuar një zhurmë dhe kur e kanë kthyer kokën te vendi ku ishte ulur i dëmtuari J. kanë vërejtur se personi që ishte me të akuzuarin A.

<sup>7</sup> Gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit Jeton Shkodra, nga ana e prokurorit Shaban Spahiu ka prezantuar edhe mbrojtësi i të akuzuarit Ruzhdi Maliqi, avokati Xhymshiti Xhymshiti.

<sup>8</sup> Gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit Gazmend Murati nga ana e prokurorit Shaban Spahiu ka prezantuar edhe mbrojtësi i të akuzuarit Ruzhdi Maliqi, avokati Xhymshiti Xhymshiti.

Xh. duke gjuajtur me sende që kishin në tavolinë në drejtim të dëmtuarit J.. Por se në cilin vend e ka goditur të dëmtuarin J. nuk e ka vërejtur mirëpo kur kanë dalur nga kafiteria e ka vërejtur të dëmtuarin J. të përgjakur në buzë. Të njëjtin e ka marrë dhe së bashku me shokun e tij J. Sh. e kanë dërguar me një taksì në Emergjencë. Mirëpo, para se ta dërgonin të njëjtin në Emergjencë, në momentin kur vetura ka arritur, personi që kishte sulmuar të dëmtuarin J. e kishte një tel apo thikë që e mbante në dorë dhe ka tentuar ta sulmojë përsëri të dëmtuarin J. duke e kapur dorëzën e derës së veturës. Në ato çaste i akuzuari A. që ishte prapa këtij personi, e ka tërhequr mbrapa të njëjtin.

Dëshmitari gjithashtu ka deklaruar se nuk e ka vërejtur që i dëmtuari J. ta ketë sulmuar personin që ishte së bashku me të akuzuarin A. Xh. derisa të njëjtit ishin në kafiteri.

Pas pyetjes së parashtruar nga ana e mbrojtësit të akuzuarit R. M., avokati Xh. Xh., dëshmitari G. M., ka deklaruar se “i akuzuari R. e ka goditur J. in me sendet që kanë qenë në tavolinë dhe me gota. Ndërsa, sa i përket thikës që ka pasur i akuzuari R. i njëjti ka shtuar se përveç që ka pasur ngjyrë të bardhë dhe të mbrehtë nuk ka mundur të jep përshkrime tjera”.

2.2.3. Dëshmitari B. N., gjatë marrjes në pyetje në PPQ në Gjilan, me datën ... 2012,<sup>9</sup> ka deklaruar se ditën kritike derisa ishte me automjetin e tij në trotuarin e rrugës përballë kafiterisë “...” në Gj., në një moment ka vërejtur disa femra duke dalur me shpejtësi nga kafiteria, si dhe ka vërejtur që pas tyre ka dal edhe J. Sh. me G. M., të cilët i kishte njohur më parë. Së bashku me ta ishte edhe një person i cili e kishte buzën e përgjakur dhe që të tre këta persona kanë hyrë në veturën e tij dhe kanë kërkuar nga i njëjti, duke i thënë “B. grahi për Emergjencë” dhe posa ka filluar ta ndezë veturën në ato çaste ka vërejtur një person tjetër të panjohur për të, i cili me shpejtësi e ka kapur derën e mbrapme të djathtë me qëllim që ta qel për të sulmuar, mirëpo, të njëjtin e kishte kapur A. Xh. dhe e kishte larguar. Pas kësaj ishte nisur me veturën e tij drejt Emergjencës dhe pasi që kanë arritur tek Emergjenca, J. Sh. e ka njoftuar se personi që ka dashur ta hapte veturën e paska prishur dorëzën e derës. Pas kësaj është kthyer te kafiteria dhe nga policia është njoftuar se personi që e ka sulmuar të dëmtuarin ishte R. M.. Dëshmitari ka shkuar te prindi i të akuzuarit të cilit i ka treguar për dëmin që ia kishte shkaktuar i akuzuari R. M. të cilin dëm prindi i tij dëshmitarit ia ka kompenzuar duke ia paguar shumën e të hollave prej 30 Euro.

### 2.3. Provat materiale

---

<sup>9</sup> Gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit Bekim Nuhiu nga ana e prokurorit Shaban Spahiu ka prezantuar edhe mbrojtësi i të akuzuarit Ruzhdi Maliqi, avokati Xhymshiti Xhymshiti.

Nga fotografitë që gjenden në shkresa të lëndës shihet Kafiteria "...", si dhe dorëza e dëmtuar e veturës me të cilën është dërguar në Emergjencë i dëmtuari J. Q..

Nga mendimi i ekspertit mjeko-ligjor Dr.S. M., nr.19/04-14, të datës 16.04.2014 shihet se i dëmtuari J. Q., ka pësuar lëndime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme për shëndetin, për shkak të plagëve ndrydhëse prerëse në regjionin e fytyrës afër buzës së poshtme, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (i mprehtë). Ndërsa, nga Raporti i Emergjencës së Spitalit Regjionale të Gjilanit, nr.2396, të datës 17.02.2012, shihet se i dëmtuari J. Q., i është nënshtruar tretmanit mjekësor për shkak të lëndimeve të shkaktuara në fytyrë, afër buzës.

#### 2.4. Deklarimet e të akuzuarve

2.4.1. I akuzuari R. M., gjatë marrjes në pyetje në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se ditën kritike derisa ka qenë në Kafiterinë "...", ka ardhur edhe i akuzuari A. Xh. ndërsa pak më vonë kanë ardhur edhe i dëmtuari J. Q., së bashku me dy persona tjerë. Pas kësaj ka filluar një bisedë dhe fjalosje në mes të akuzuarit A. Xh.dhe të dëmtuarit J. Q.. Derisa ishin duke u fjalosur i akuzuari A. me të dëmtuarin J. , i akuzuari R.e ka pyetur të dëmtuarin J. "se çka është fjala", ndërsa i dëmtuari J. ia ka kthyer me fjalët "çka u bo, çka po din ti" dhe ka shkuar në drejtimin e të akuzuarit R.. Pas një shtyrje në mes vete, i akuzuari R.e ka goditur të dëmtuarin J. me një shishe të vogël të qelqit në buzë, ngase sipas të akuzuarit R. paraprakisht i dëmtuari J. e ka gjuajtur me një shishe të birrës. Përveç me shishe, i akuzuari R.ka deklaruar se të dëmtuarin e ka gjuajtur edhe me shpuzore, mirëpo të njëjtin e kam lënduar me shishe. Derisa të njëjtit kanë qenë në kafiteri, i akuzuari R.ka deklaruar se nuk ka patur me vete ndonjë send tjetër dhe e ka mohuar faktin të ketë patur ndonjë thikë me vete, mirëpo sipas tij i njëjti ka patur me vete çelsat dhe telefonin. Nuk e ka ditur arsyen pse ka shkuar te vetura e taksistit, edhe pse babai i tij ja ka paguar dëmin e bravës së taksistit.

Ndërsa, gjatë marrjes në pyetje nga ana e prokurorit në PPQ në Gjilan, i akuzuari R. M., kishte deklaruar se "pasi kam dal nga kafiteria kam vërejtur se J.i është futur në taksi me shokët e tij dhe i revoltuar kam shkuar për ta sulmuar, por e kam hapur derën e veturës kam arritur ta hap të njëjtën, por kur e kam parë J.in e përgjakur nuk e kam sulmuar".

2.4.2. I akuzuari A. Xh. gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se ditën kritike kur ka filluar konflikti në mes të akuzuarit R.dhe të dëmtuarit J., i njëjti vetëm ka patur rol ndërmjetësues, ngase ka hyrë për t'i ndarë të njëjtit. Se i akuzuari R. nuk ka patur dijeni për mosmarrëveshjen që ka patur i

akuzuari A. me të dëmtuarin J.. Nuk i është kujtuar nëse i akuzuari R.ka tentuar ta sulmojë me thikë të dëmtuarin J. jashtë kafiterisë.

### 3. Vlerësimi i provave

Trupi gjykues i ka vlerësuar me shumë kujdes të gjitha provat të cilat janë proceduara gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor dhe ka ardhur në përfundim se duhet t'i besohet pjesërisht deklarimit të të akuzuarit R. M., në pjesën që e ka pranuar faktin “se ditën kritike me një shishe e ka goditur të dëmtuarin J. Q.”. Kjo për faktin se një gjë e tillë argumentohet edhe nga provat tjera që janë procedurara gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor, siç janë dëshmia e të dëmtuarit J. Q.; dëshmitë e dëshmitarëve J. Sh. dhe G. M., si dhe provat materiale. Ndërsa, pjesës tjetër të deklaratës së të akuzuarit R. M., “se nuk ka patur thikë ditën kritike dhe se paraprakisht kinse i dëmtuari J. Q. e ka gjuatur me shishe”, nuk ja fA. besimin, për shkak se nuk gjen mbështetje në provat tjera.

Sa i përket deklaratës së të dëmtuarit J. Q., trupi gjykues të njejtin e ka vlerësuar si bindëse dhe e qart, edhe pse i njejtin në disa pika i është shmangur (me ose pa qëllim) deklaratës së tij të dhënë në PPQ në Gjilan. Përmes dëshmisë së të dëmtuarit J. Q., është vërtetuar se ditën kritike në Kafiterinë “...” në Gj., i akuzuari R. M., e ka goditur me shishe në buzë, ku edhe ka patur gjakderdhje. Një pretendim i tillë i të dëmtuarit është në harmoni me të gjitha provat që janë proceduar gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor dhe një gjë e tillë nuk është edhe kontestuese, për shkak se edhe i akuzuari R. M., e ka pranuar këtë fakt. Gjithashtu, nga deklarata e të dëmtuarit J. Q., të dhënë në PPQ në Gjilan, është vërtetuar fakti se “i akuzuari R. M. ditën kritike ka patur thikë me vete”, fakt ky i cili është deklaruar edhe nga ana e dëshmitarëve J. Sh. dhe G. M. .

Sa i përket dëshmisë së dëshmitarit J. Sh., trupi gjykues të njejtin e ka vlerësuar si deklaratë mjaft e rëndësishme, për shkak se i njejtin në mënyrë të qart ka deklaruar se “se i dëmtuari J., kishte gjakderdhje në buzë dhe të njejtin e kanë futur në një veturë taksit dhe në ato qaste ka ardhur i akuzuari R. i cili është ofruar te vetura me thikë në dorë dhe ka dashur që ta hap derën e veturës me qëllim që ta sulmojë J.in, mirëpo i njejtin nuk ka arritur që ta hap derën e veturës, ngase e njejtin ishte e mbyllur me bravë nga brenda..”. Nga ky deklaram i dëshmitarit J. Sh., në mënyrë të drejtpërdrejt vërtetohet se i akuzuari R. M., ka patur thikë me vete dhe me të njetin ka dashur që ta vazhdojë sulmin ndaj të dëmtuarin, mirëpo nuk ka arritur që ta hap derën e veturës. Dëshmia e këtij dëshmitari, është vlerësuar shumë nga ana e trupit gjykues, për shkak se i njejtin ka qenë dëshmitar okular dhe dëshmia e tij është në harmoni me provat tjera, përveç pjesës që ka deklaruar se “i akuzuari R. M., me gotë e ka goditur të dëmtuarin”, ngase është vërtetuar që i akuzuari R. M., të dëmtuarin e ka goditur me shishe e jo me gotë.



Edhe përmes dëshmisë së dëshmitarit G. M., është vërtetuar se i akuzuari R. M., ditën kritike e ka goditur të dëmtuarin J. Q., dhe se i akuzuari kishte dashur që ta sulmonte të dëmtuarin me thikë e cila kishte ngjyrë të bardhë.

Fakti se i akuzuari R. M., ka dashur që ta sulmojë të dëmtuarin J. Q., pasi që i njejtë veç kishte hyrë në veturën taksit, vërtetohet edhe nga dëshmia e dëshmitarit B. N., dëshmia e të cilit është në harmoni me dëshminë e të dëmtuarit dhe dëshmitarëve, si dhe me provat materiale.

Nga të gjitha ka prova, është vërtetuar fakti se i akuzuari R. M., ditën kritike me shishe e ka goditur në fytyrë të dëmtuarin J. Q.; se i akuzuari R. M., kishte dashur që me thikë ta vazhdojë sulmin ndaj të dëmtuarin J. Q., pasi që i njejtë veç kishte hyrë në veturë, si dhe nuk është vërtetuar i dëmtuari J. Q., e ka goditur paraprakisht të akuzuarin R. M..

#### 4. Elementet e veprave penale

Sipas nenit 146 të KPK, veprën penale të vrasjes e kryen “kushdo që e privon personin tjetër nga jeta”. Pra, veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në privimin nga jeta të personit tjetër dhe për këtë veprë penale është parashikuar dënimi me së paku pesë vjet burgim. Ndërsa, në nenin 20 të KPK është parashikuar tentativa për të kryer veprë penale. Kështu, në paragrafin 1 të këtij neni, është parashikuar se “Kushdo që me dashje ndërmerr veprime të drejtpërdrejta për kryerjen e veprës penale dhe vepra nuk është kryer ose elementet e veprës së qëllimshme penale nuk janë realizuar, ai konsiderohet se ka tentuar të kryejë veprë penale”. Kurse, në anën tjetër, në nenin 153 paragrafi 1 nënparagrafi 4 të KPK, është parashikuar se forma themelore e veprës penale të lëndimit të lehtë trupor, sipas të cilës, këtë formë të kësaj vepre penale e kryen “Kushdo që personit tjetër i shkakton lëndim të lehtë trupor, i cili rezulton me dëmtim të përkohshëm të shëndetit të personit tjetër”. Formë e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në nenin 153 paragrafi 2 të KPK, e cila ekziston në rastet kur “vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni “është kryer me armë, me ndonjë mjet të rrezikshëm ose me ndonjë send tjetër të përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit” dhe për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim deri në tre vjet. Me fjalë tjera, formën e rëndë të veprës penale lëndimi i lehtë trupor, sipas nenit 153 paragrafi 2 të KPK, “e kryen personi i cili lëndimin e lehtë trupor e shkakton me armë, me ndonjë mjet të rrezikshëm ose me ndonjë send tjetër të përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit”.

#### 5. Gjendja faktike e vërtetuar dhe rikualifikimi ligjor i veprës penale

Andaj, pas administrimit të gjitha provave gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, trupi gjykues e ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

- se i akuzuari R. M., me dashje e ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor, nga neni 153 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nënparagrafi 4 të KPK, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi.

Trupi gjykues, duke u bazuar në nenin 360 paragrafi 2 të KPP,<sup>10</sup> ka ardhur në përfundim se nga provat e administruara gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor; pastaj nga rrjedha e ngjarjes që ka ndodhur ditën kritike në Kafiterinë “...” dhe jashtë saj; nga motivi i kryerjes së veprës penale; mënyra e veprimit të të akuzuarit, etj. nuk është vërtetuar se i akuzuari R. M., ka tentuar që ta privojë nga jeta të dëmtuarin J. Q.. Përkatësisht, nuk është vërtetuar që i akuzuari R. M., ka dashur që ta privojë nga jeta të dëmtuarin J. Q., por sipas vlerësimit të trupit gjykues, në bazë të rrethanave objektive se si është zhvilluar ngjarja, qëllimi dhe dashja e të akuzuarit R. M., ka qenë e orientuar në shkaktimin e lëndimeve të dëmtuarit J., edhe pse i njëjti ka tentuar që përsëri ta vazhdojë sulmin ndaj të dëmtuarit J. Q., pasi që i njëjti veç kishte hyrë në veturë për tu dërguar në Emergjencë. Në anën tjetër, trupi gjykues ka konstatuar se “shishja” të cilin e ka përdorur i akuzuari R. M. e me të cilin është shkaktuar lëndimi i të dëmtuarit J., si dhe “thika” me të cilin ka tentuar që ta vazhdojë sulmin, janë sende të përshtatshme për shkaktimin e lëndimeve të rënda trupore ose dëmtimin e rëndë të shëndetit. Duke u bazuar në të gjitha këto arsye, veprimet e të akuzuarit R. M., si nga aspekti subjektiv, ashtu edhe nga aspekti objektiv, janë rikualifikuar, si lëndime të lehta trupore, nga neni 153 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nënparagrafi 4 të KPK.

## 6. Vendimi për shpalljen fajtor të të akuzuarit R. M.

Duke u bazuar në këto që u cekën në arsyetimin e këtij aktgjykimi, trupi gjykues e shpalli fajtor të akuzuarin R. M., për shkak të kryerjes së veprës penale lëndimi i lehtë trupor, nga neni 153 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nënparagrafi 4 të KPK, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë elementet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe penalisht përgjegjës.

## 7. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

---

<sup>10</sup> Në nenin 360 paragrafi 2 të KPP, është parashikuar se “gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës”.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit R. M., trupi gjykues i ka marrë për bazë disa rrethana që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas nenit 64 të KPK. Në këtë aspekt, si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, trupi gjykues i ka marrë për bazë sjelljet e mira të akuzuarit gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor; se i njëjti është pajtuar me të dëmtuarin J. Q., si dhe faktin se sipas deklaratës së të akuzuarit, të cilës trupi gjykues ja fA. besimin, i njëjti është i martuar dhe baba i një fëmije. Ndërsa, trupi gjykues si rrethanë rënduese për të akuzuarin e ka marrë për bazë faktin se i njëjti edhe më parë ka qenë i dënuar për vepra tjera penale. Kështu, i akuzuari R. M., me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Komonale në Gjilan, P.nr.1080/2009, të datës 23.08.2012, është shpallur fajtor për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor, nga neni 153 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK; me aktgjykimin e formës së prerë P.nr.1184/2011, të datës 26.09.2013, të kësaj Gjykate, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, i akuzuari është shpallur fajtor për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor, nga neni 153 paragrafi 1 nënparagrafi 4 të KPK; me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, P.nr.191/2007, i akuzuari është shpallur fajtor për shkak të veprës penale lëndimi i rëndë trupor, nga neni 154 paragrafi 2 nënparagrafi 3 lidhur me nenin 23 të KPK; me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, P.nr.161/2009, i akuzuari është shpallur fajtor për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontrollë, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328 paragrafi 2 të KPK dhe gjithashtu, me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, P.nr.162/2009, i akuzuari është shpallur fajtor për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontrollë, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328 paragrafi 2 të KPK. Poashtu, si rrethanë rënduese për të akuzuarin R. M., trupi gjykues e ka marrë për bazë edhe faktin se i njëjti ka qenë në arrati nga data e ka kryer veprën penale e deri më datën 27.02.2012, ku është dorëzuar në Stacionin Policor në Gjilan.

#### 8. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së trupit gjykues, dënimi me burgim i shqiptuar ndaj të akuzuarit R. M., duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit. Trupi gjykues, vlerëson se me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 34 të KPK, i cili konsiston në parandalimin e akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të përmbajë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

## 9. Vendimi lidhur me paraburgimin

Trupi gjykues, duke u bazuar në nenin 73 paragrafi 1 dhe 4 të KPK, ka vendosur që të akuzuarit R. M., koha e kaluar në paraburgim prej datës 27.02.2012 e deri më datën 23.03.2012, t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim, ashtu që 1 (një) ditë e qëndrimit në paraburgim do të barazohet më 1 (një) ditë e dënimit me burgim.

## 10. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Meqë i dëmtuari J. Q., gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se nuk paraqesë kërkesë pasurore-juridike, trupi gjykues nuk ka vendosur për një kërkesën pasurore-juridike.

## 11. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës për të akuzuarin R. M.

Duke e pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarit, duke u bazuar në nenin 451 të KPP, trupi gjykues ka vendosur që i akuzuari R.M. të detyrohet për t'i paguar shpenzimet e procedurës penale dhe atë shumën prej 50 €, në emër të paushallit gjyqësor, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

## 12. Vendimi për refuzimin e akuzës ndaj të akuzuarit A. Xh.

Duke u bazuar në nenin 363 paragrafi 1 nënparagrafi 1 të KPP, trupi gjykues ka vendosur që të refuzohet akuza ndaj të akuzuarit A. Xh. për shkak se prokurori i shtetit gjatë fjalës përfundimtare, në mungesë të provave është tërhequr nga ndjekja penale.

## 13. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale për të akuzuarin A. Xh.

Trupi gjykues, duke u bazuar në nenin 454 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që shpenzimet e procedurës penale sa i përket të akuzuarit A. Xh. paguhen nga mjetet buxhetore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Duke u bazuar në të gjitha këto që janë cekur në arsyetimin e këtij aktgjykimi, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
Departamenti i Krimeve të Rënda  
Më 19.06.2015

Sekretarja juridike,  
Vahide Dërmaku

Kryetari i trupit gjykues,  
Afrim Shala

**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.